

Shtojca 2

**PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE**

(Sipas natyrës)

**31 Dhjetor 20XX**

(Monedha \_\_ )

<b>Zërat e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve</b>	<b>Përshkrimi i ngjarjeve dhe transaksioneve që përfshihen në zërat përkatës</b>
<b>Shitjet neto</b>	<i>Të ardhurat e përftuara nga shitja e produkteve, mallrave dhe shërbimeve gjatë periudhës kontabël</i>
<b>Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<i>Të ardhurat që përftohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike, duke përfshirë fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale ndryshimet në llogaritë/kërkesat e arkëtueshme dhe detyrimet për t'u paguar furnitorëve (nëse rezulton një humbje neto, ajo njihet në zërin "Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit")</i>
<b>Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe punës në proces</b>	<i>Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe punës në proces, ku pakësimet e pozicioneve njihen si shpenzime dhe rritjet e pozicioneve si pakësim i shpenzimeve</i>
<b>Puna e kryer nga njësia ekonomike raportuese për qëllimet e veta dhe e kapitalizuar</b>	<i>Materialet dhe shërbimet që janë përdorur në prodhimin e aktiveve afatgjata dhe që janë njohur si shpenzim në një zë tjetër të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, njihen si një pakësim i këtij zëri</i>
<b>Mallrat, lëndët e para dhe shërbimet</b>	<i>Kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara në prodhim për veprimtaritë parësore (për shembull, veprimtaritë e prodhimit ose shitjeve)</i>
<b>Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<i>Kosto e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, të blera për qëllime administrative dhe të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë parësore (për shembull, kostoja e shërbimeve për mbajtjen e llogarive, shpenzimet për këshillim, shpenzimet për zyrën, sigurimet e jetës ose pronës, shpenzimet e reklamave, shpenzimet e kërkim zhvillimit, shpenzimet e lidhura me krijimin e provizioneve, shpenzimet për shumat e parashikuara për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta etj.) <i>Gjithashtu, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit, duke përfshirë humbjen nga shitje afatgjata materiale, shumat e gjobave dhe</i></i>

	<i>ndëshkimeve, si dhe ndryshimet në vlerën e kërkesave për t'u arkëtuar dhe detyrimeve ndaj furnitorëve (nëse rezultati është një fitim neto, ai njihet në zërin "Të ardhura të tjera nga veprimtari shfrytëzuese")</i>
<b>Shpenzime të personelit</b>	
<i>Pagat</i>	<i>Pagat, shpërblimet, pagat për lejet vjetore, festat dhe kompensime të tjera monetare e jomonetare gjatë periudhës kontabël, pavarësisht nga fakti nëse ato janë paguar ose jo</i>
<i>Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore</i>	<i>Sigurimet shoqërore dhe primi i sigurimit për papunësinë, paguar nga njësi ekonomike raportuese, mbi pagesat e paraqitura në zërin e mësipërm</i>
<b>Amortizimi</b>	<i>Shpenzimi i amortizimit të aktiveve afatgjata për periudhën</i>
<b>Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	
<b>Të ardhurat dhe shpenzimet financiare</b>	
<i>Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi</i>	<i>Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit mbi huat bankare dhe hua të tjera me interes</i>
<i>Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi</i>	<i>Fitimi/humbja nga ndryshimi i kursit të këmbimit të kërkesave për t'u arkëtuar dhe detyrimeve për t'u paguar (për shembull, huat e dhëna dhe të marra) në monedhë të huaj e që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese</i>
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>	
<b>Fitimi (humbja) para tatimit</b>	
<b>Shpenzimet e tatimit mbi fitimin</b>	
<b>Fitimi (humbja) neto e vitit financiar</b>	